

URDHËR
Nr. 595, datë 29.5.2026

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË
VEGJËL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera në qarkun Vlorë.

2. Ndalimin e lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël (PPR)”.

9. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6, zbatohen në territorin e:

Nr.	Njësia Administrative	Fshati
3 km		
1.	Xarrë	Shkallë
2.	Konispol	Çiflik
3.	Konispol	Konispol
10 km		
1.	Xarrë	Xarrë
2.	Xarrë	Mursi
3.	Markat	Vervë
4.	Markat	Shalës
5.	Markat	Dishat
6.	Livadhja	Vagalat

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla